



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, duke vendosur sipas kërkesës Nr.1-400-68672 të dates 03.11.2021 të Shoqatës "OMPAKL" dega në Lipjan, Kryetari i Komunes nxjerr:

**VENDIM  
PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE**

**Neni 1**

I ndahet shuma e mjeteve në vlerë prej 200 € (dyqind euro), Organizatës multietnike e personave me aftësi të kufizuara "OMPAKL" dega në Lipjan, sipas kërkesës së tyre Nr.1-400-68672 të dates 03.11.2021 për realizimin e aktiviteteve për nder të "3 dhjetorit" ditës Ndërkombëtare të Përsonave me Aftësi Ndryshe.

**Neni 2**

Shuma e cekur nga neni 1 do të paguhet nga mjetet e buxhetit të Komunës së Lipjanit për vitin 2021 pozicioni buxhetor- subvencionet e planifikuara për Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport në xhirollogarinë bankare të Shoqatës së "OMPAKL" dega në Lipjan në nr. 1907946619031150 në BKT bankë.

**Neni 3**

Lidhur me mjetet e shpenzuara i lartëcekuri duhet të sjell raport dëshmi deri në shumën e lejuar dhe të njëjtat ti dorëzojë në Drejtoratin për Kulturë, Rini dhe Sport.

**Neni 4**

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

**Neni 5**

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Shoqata "OMPAKL" dega në Lipjan.

1Nr.400-68672

Lipjan, më 23.11.2021

KRYETARI KOMUNËS  
Imri Ahmeti

